Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kreshnik Spahiu	**19.07.2024**	**30.07.2024**	**2024/0607**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.07.2024, OE "RIO PLUS SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0607, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "MSS Mobile Sanitary Services" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "'Mirembajtja higjienike ne ndertesa qeveritare Lot – I dhe Lot – II'' me numër të prokurimit: "214-24-3205-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme. AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 537,363.54 euro.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Pretendimet ankimore

Me qense AK nuk ka dhene pergjigjiet e merituara sipas LPP-se ne po e ri shkruajm: Pas vendimit te AK-se per Rekomandim te nje OE-se i cili sipas LPP-se dhe DT-se nuk eshte i pergjegjeshem si nga ana administrative ashtu edhe nga ajo financiare. Bazohemi ne keto pasi qe OE ne fjal nuk ka zbatuar ne perpikmeri kersat tuaja veqanerishte ato lidhur me pagen dhe shpenzimet tjera. Ju ne kerkesen tuaj per sqarim keni kerkuar qe te jepet sqarim pasi qe bazuar ne kerkesat e tuaja OE eshte fakt se ka qmimin apnormal te ulet. OE ne sqarimin e dhene nuk ka te perfshira te gjitha elementet sipas ligjeve ne fuqi por se ka bere nje kamufllim te situates duke lene paqartesi. OE ne sqarimet e ofruar ne "analizen" e prezantuar nuk ka te kalkuluar shpenzimet per pushim vjetro,TVSH-ne, dhe as shpeznimet e materialit. Qmimi i OE-se bie ndesh me kerkesen tuaj ne DT ku keni kerkuar respektim te Ligjit te Punes duke mbrojtur te drejtat e punetorve. Veprim i juaji tendencioz dhe favorizues per kete OE eshte dhe kerkesa per rritjen e egzekutimit te sigurmit te kontrates nga 10% ne 20% qe i bie se prap ne nje form ju keni rritur kostot e shppenzimit te OE-se pasi qe vlera per marrjen ne kete vler e rrit shpenzimin dhe e bene edhe me te pamundur implementimin e kontrates, por se veprimet tuaja favorizuese shkojn ne deme te puntorit dhe nje ashtu ne diskriminim te ofertes tone.

Duke u mbeshtet në ato që cekem kërkojm

VENDIM MBI APROVIMIN E ANKESES TONE

Duke e kthyer lëndën në RIVLERËSIM dhe shapllu ofertën tonë më të lirën të përgjegjëshme.

Brenda afatit ligjor do e plotesojm ankesën

KRITERET PËR VLERËSIM

n/a

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i vleresimit krahasimit·dhe ekzamini mit te ofertave, per tenderin " Mirembajtja higjienike ne ndertesa qeveritare Lot – I dhe Lot – II'' pas shqyrtimit te teresishem te dokumentacionit te dorezuar nga tenderuesit ne tenderer e tyre, elaborimeve dhe sqarimeve te larte shenuara si dhe duke u bazuar ne kriterin per dhenien të kontrares të percaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosje te tenderit (Tenderi i pergjegjshem me çmimin me te ulet)

i rekomandojmë zyrtarit pergjegjes te prokurimit, qe me kete kontrate te shperbleher tenderi i pergjegjshem me çmimin me te ulet te tenderuesit, Operatori Ekonomik MSS Mobile Sanitary Services SH.P.K., Zona Ekonomike, Magj. Prishtine-Mitrovice, 10000, Prishtine1 per Lot -I Mirembajtja higjienike ne ish Bauken e Lubljanes" ne vlere totale te te ofertes 74,579.40€ dhe per Lot -II ". Mirembajtja higjienike ne ish Kulla e Rilindjes me objekte percjellese në vlere totale te ofer!es 373,362.48€.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **RIO PLUS SH.P.K.**

Sqarim hyrës: Parashtruesi i ankesës – "RIO PLUS SH.P.K." (më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 25.06.2024, përderisa AK me datë 28.06.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur të rekomandoj për kontratë OE i cili ka ofruar me çmim jonormalisht të ulët dhe i cili nuk ka prezantuar analizën financiar me kostot për këtë aktivitet të prokurimit.

Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor

AK me datë 20.06.2024 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së përmes të cilit rekomandohet për kontratë për të dy pjesët OE "MSS Mobile Sanitary Services SH.P.K". Për Lot 1 çmimin i OE të rekomanduar është 74,579.40 euro, përkatësish për Lot 2 është 373,362.48 euro.

AK, me datë 28.05.2024 përmes e-prokurimit kishte dërguar letrën standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit tek OE i rekomanduar për kontratë. AK kishte kërkuar nga OE sqarime si vijon: "*Kërkojmë që të ofroni ANALIZË FINANCIARE të detajuar për ofertat tuaj (për secilin Lot veç e veç) për Lot – I dhe Lot – II'' si keni menduar ti realizoni këto kontrata me çmimin e ofruar duke pasus parasysh që ju keni ofruar një Çmimi jashtëzakonisht jo normalisht të ulët për këtë Aktivitet si dhe të rikonfirmoni se a qëndroni prapa ofertave të ofruar për secilin Lot veç e veç .''*

Me datë 29.05.2024 OE i rekomanduar kishte kthyer përgjigje në kërkesën për sqarim ku thekson: Kompania jone do te jep këto sqarime siç vijon:

Lot I

Totali I pagave për 36 muaj është 59 724.00€, diferenca e mbetur nga çmimi total I ofertës për Lot I është 14 855.40€

Cmimi jone nuk eshte jo normalisht i ulet dhe nuk mund te konsiderohet si i tille duke pasur parasysh se nga cmimi me i lire deri te gmimi i katert me i shtrejt ne renditje diferenca ne total eshte me pak se 10% dhe ky konstatim eshte tërësisht i pa bazuar.

Lot I

MSS Sh.p.k. - 74 579.40 €

Rio plus sh.p.k. Guard De Capital sh.p.k. Skyfterat-Live sh.p.k.- 75 325.66€

Efa Dienstleistung GmbH - 76 372.99€

Erik sh.p.k. - 76 617.80€

Internacional group Base;lnternacional Security AAH sh.p.k.-77 303.51€ Schafberger Jr Gmbh — 79 269.11€ Laguna sh.p.k.- 79 904.88€.

MSS konfrimon se qendrojm teresisht pas Ofertes tone LOT I dhe jemi te gatshem te zbatojme te gjitha kerkesat e AK-se qe dalin nga specifikimet teknike te dosjes se tenderit ne raste se ne shpallemi fitues.

LOT II

Kompania jone do te jep keto sqarime sic vijon:

Kërkojmë që të ofroni ANALIZË FINANCIARE të detajuar për ofertat tuaj (për secilin Lot veg e veg) pär Lot — I dhe Lot — 11" si keni menduar ti realizoni këto kontrata me gmimin e ofruar duke pasus parasysh që ju keni ofruar një Cmimi jashtëzakonisht jo normalisht të ulët për këtë Aktivitet si dhe të rikonfirmoni se a qëndroni prapa ofertave tä ofruar për secilin Lot veg e vec.

Ne baze te specifikiemeve teknike te dosjes se tenderit saktesisht pikes 9.2.4 FDT ku kerkohet "OE duhet te dorezoje deklarat me shkrim te nenshkruar dhe vulosur se do te paguaj Pagen Baze per nje muaj per nje punetore ne shume prej jo me pak se 395.euro bruto" dhe sipas kerkeses ne dosje te tenderit pika 10 faqe 37 "AK konform nenit 61 te LPP e ruan te drejten qe te kerkoi edhe informata shtes dhe analiza shtes financiare ne raste se mendon se OE nuk iu eshte permbajjtur ligjeve dhe rregullave ne fuqi sa i perker pagave dhe nuk ofron deshmi bindese se si do te realizoi kontraten" dhe poashtu sipas nenit 6.5.8 ugdo ofert qe nuk e mbulon pragun e shpenzimeve te pagave te punetoreve do te shpallet e pa pergjegjshme" MSS jep kete analize financiare ne baze te kerkesave te lartecekura:

Lot II

Totali I pagave per 36 muaj eshte 313 551.00€, diferenca e mbetur nga cmimi total I ofertes per Lot II eshte 59 811.48€

Cmimi jone nuk eshte jo normalisht i ulet dhe nuk mund te konsiderohet si i tille duke pasur parasysh se nga cmimi me i lire deri te qmimi i katert me i shtrejt ne renditje diferenca ne total eshte me pak se 10% dhe ky konstatim eshte teresisht i pa bazuar.

Lot 2

MSS Sh.p.k. - 373 362.48€

Efa Dienstleistung GmbH 392 219.65€

Rio plus sh.p.k. Guard De Capital sh.p.k. Skyfterat-Live sh.p.k.- 394 344.00€

Internacional group Base;lnternacional Security AAH sh.p.k. 411 458.46€

Laguna sh.p.k.- 418 573.08€

Erik sh.p.k -420 015.69€

Schafberger Jr Gmbh 437 130.14€

MSS konfrimon se qendrojm teresisht pas Ofertes tone LOT II dhe jemi te gatshem te zbatojme te gjitha kerkesat e AK-se qe dalin nga specifikimet teknike te dosjes se tenderit ne raste se ne shpallemi fitues.

MSS eshte e gatshme ne cdo kohe teju ofroj informacione shtes sipas kerkesave tejuaja."

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor

Eksperti sqaron se AK konform paragrafit 4 të nenit 41 ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë duke marrë për bazë çmimin e ofertuar. AK në kërkesën për sqarimin e tenderit e kishte cilësuar çmimin e ofertës së OE të rekomanduar si "Çmim jashtëzakonisht jo normalisht të ulët". Përgjigjja e OE të rekomanduar përveç kalkulimit të pagave të stafit nuk përmban asnjë element tjetër ashtu sikurse përcaktohet në paragrafët 8 dhe 9 të nenit 41 të RrPP. Për Lot 1 çmimi i ofertuar (me TVSH) nga OE i rekomanduar është 74

579.40 euro, ndërsa vetëm kostoja e personelit për realizimin e kontratës është 59 724.00 euro. Diferenca i bie të jetë 14,850.40. Duke qenë që çmimi i ofertuar përfshinë të gjitha taksat, nuk është zbërthyer as vlera e TVSH-së që zbritet nga shuma. Për me shumë kontrata përfshinë kohëzgjatjen prej 36 muajve dhe në dosjen e tenderit (faqe 30) përcaktohet se materialin për realizimin e mirëmbajtjes higjienike duhet ta sigurojë vet kontraktori, ku ndër të tjera kërkohet që minimumi i artikujve të nevojshëm për pastrim të cilat kontraktori duhet siguruar në sasi të nevojshme pavarësisht nga shpenzimi – hargjimi i tyre të cilat janë: *letër tualeti, dy shtresorë e bardhë e kualitetit të lartë (celuloze pastër me standard dhe përshkrim), letër për duar e trashë, e bardhë, e gjerë (dyfishi i tualet letrës) e kualitetit të lartë, varësisht nga mekanizmat e instaluara për mbajtjen e letrës, mekanizmat e letrës se duarve i vendos përfituesi i OE, sapun të lëngshëm, dezodorant për urina lë, tableta dezinfektuese, plastika – goma të shpuara më dezinfektues në brendësi dhe të përshtatshme për pisuar, sapun dezodorant (përfshirë edhe shportën) për guaca, dezinfektues të tualeteve, dorëza plastike për pastruesit, detergjent për pastrimin e dritareve të jetë ekologjike, sipas standardeve, detergjent për pastrimin e dyshemesë të jetë ekologjike, sipas standardeve, detergjent për pastrimin e tepihëve të jetë ekologjike, sipas standardeve, qeska për të gjitha llojet e kontejnerëve - shportave të mbeturinave, qeska për shportat e letrave, dezodorans për kabinete, zyrë, salla, toalete, detergjent per pastrimin e pllakave, dofë për pastrimin e dyshemesë, kripë për shkrirjen e borës, akullit, kripë me rërë për shkrirjen e borës, akullit, polir (shkëlqyes) për mobile, polir (shkëlqyes) per metal dhe mesing, detergjent për qeramike, detergjent për heqjen e njollave, etj.* Nëse merren për bazë parametrat e përafërt për zbatimin e kontratës disa nga treguesit që e përcaktojnë edhe pjesën e materialeve shpenzuese janë: objekti në Lot 1 përfshinë disa institucione publike (Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Institucioni i Avokatit të Popullit, Autoriteti i Konkurrencës) ku punojnë rreth 200 nëpunës dhe janë disa tualete, andaj këta tregues do të duhej ti shërbenin AK-së si përcaktues për të kalkuluar së paku shpenzimet minimale të materialeve që shpenzohen në këtë kontratë në mënyrë që të vlerësohej besueshmëria e ofertuese.

Përfundimisht, eksperti thekson se analiza e OE të rekomanduar për kontratë nuk i përmban as elementet bazike të zbërthimit të çmimeve në mënyrë që të pasqyrohet besueshmëria e ofertuesit, ashtu sikurse përcaktohet në paragrafin 8 të nenit 40 ku thuhet se gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulet, AK duhet të merr në konsideratë:ekonominë e shërbimeve të ofruara, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, dhe/ose origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Duke qenë kështu eksperti vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar dhe AK duhet që gjatë rivlerësimit të kërkojë nga OE-të zbërthimin e kostove të shërbimeve dhe furnizimeve të cilat përfshihen në dosjen e tenderit, duke marrë për bazë treguesit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **RIO PLUS SH.P.K.**

Kreshnik Spahiu